




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 17 dhe 18 të Rregullorës (QRK) nr.30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nënpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Njësia e Burimeve Njerëzore në IKSHPK si njësi përgjegjëse pasi u vendos nga Komisioni i Pranimi me vendim nr.prot.1022/01-25.04.2025, për mbajtjen e testit me shkrim për vlerësimin e kandidatëve, të cilët kanë plotësuar kriteret në Konkursin Publik nr.prot.611/12-24.03.2025 për pozitën **Zyrtar i/e lartë Ekzekutiv dhe Asistent Administrativ** i publikon njoftimin për mbajtjen e testit me shkrim:

TESTI ME SHKRIM, MBAHET ME DATË 16.05.2025 DITËN E PREMTE ORA 11:00, NË AMFITEATRIN E IKSHPK-së,

1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, duhet të realizohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak.
2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse.
3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.
5. Komisioni i pranimi përcakton peshën e secilës pyetje duke mos kaluar maksimumin prej shtatëdhjetë (70) pikëve.
6. Kohëzgjatja e testit me shkrim është jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) minuta.
7. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNJ sipas vendosjes së Komisionit të pranimi, e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testin me shkrim dhe publikon listën në SIMBNJ dhe ueb faqen e institucionit.

Në test me shkrim ruhet anonimiteti i kandidatëve. Kandidatët nuk lejohet të shkruajnë asnjë shenjë që direkt apo indirekt zbulon identitetin e kandidatit, përveç plotësimit të përgjigjeve për çdo pyetje.

Kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e konkursit dhe do t'i nënshtrohen testit me shkrim janë:

Zyrtar të lartë ekzekutiv (1 pozitë)

Nr.	Kandidati	Vërejtje
1.	Leutrim Murati	
2.	Vlora Lushtaku	

Asistent Administrative (1 pozitë)

Nr.	Kandidati	Vërejtje
1.	Arjeta Kadriu	
2.	Egzona Arifaj	
3.	Erisa Pakashtica	
4.	Merita Isufi	
5.	Yllka Ramadani	

Pas dorëzimit, testit i vendoset një kod unik për secilin kandidat.

Të gjithë kandidatët me vete duhet të posedojnë: letenjoftimin, laps-kimik me ngjyrë të kaltër.

Datë 13.05.2025



Njësia e Burimeve Njerëzore në IKSHPK